

VENDIM Nr. 144, datë 13.3.2018
PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHETËRORE “REGJISTRI
ELEKTRONIK I SUBJEKTEVE KONTROLLUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin, në zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, KDIMDP), e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese” (në vijim, RESK), përmbajtja e së cilës publikohet në faqen zyrtare të KDIMDP-së.

2. KDIMDP-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin, ndërveprimin me bazat e tjera dhe bërjen të disponueshëm të informacionit në përmbajtje të bazës të të dhënave “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese”.

3. RESK-u përmban të dhëna për:

a) qëllimin, mënyrat dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale nga kontrollues publikë dhe privatë;

b) kategoritë e të dhënave personale që përpunohen;

c) të dhënat sensitive që përpunohen;

ç) masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të dhënat që përmban RESK-u ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore janë:

i. të dhënat e kontrolluesit;

ii. fusha e veprimtarisë;

iii. kategoritë e subjekteve të të dhënave personale;

iv. kategoritë e të dhënave personale që përpunohen;

v. të dhënat sensitive që përpunohen;

vi. qëllimet e përpunimit të të dhënave;

vii. marrësi/t i/e të dhënave personale;

viii. transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale;

ix. mjetet e përpunimit të të dhënave personale;

x. masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes të të dhënave personale.

b) Të dhëna dytësore janë:

i. NIPT-i;

ii. emri/mbiemri;

iii. nr.tel./faksi;

iv. adresa.

5. Dhënësi i informacionit për RESK-un është KDIMDP-ja.

6. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të RESK-ut është, si më poshtë vijon:

a) Qytetarët (subjekte të të dhënave personale) kanë nivel aksesi si lexues dhe konsultues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion, nëpërmjet faqes së internetit të KDIMDP-së.

b) Kontrolluesit publikë dhe privatë, të cilët përpunojnë të dhëna personale, kanë të njëjtin nivel aksesi si ai i parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike.

c) KDIMDP-ja ka akses si administrator dhe përdorues në RESK. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, si dhe për punonjësit e KDIMDP-së janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren “Për sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore të krijuara në KDIMDP”, miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Baza e të dhënave të KDIMDP-së ndërvepron me kontrolluesit publikë dhe privatë, sipas ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, si dhe ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

8. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën software dhe hardware të RESK-ut në KDIMDP, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën mbrojtjes të të dhënave, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Ngarkohet zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I
EDIRAMA